

## CV TË FUNKSIONARËVE TË LARTË

### Ministri

Z. Edmond Panariti, lindi në Tiranë, më 1 Qershor të vitit 1960 dhe është i martuar me znj. Narin Panariti, me të cilën ka dy djem, Klajd dhe Bjorn Panariti.

Prof. Dr. Edmond Panariti, ka përfunduar studimet universitare në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në vitin 1984. Ai mban gradën shkencore “Doktor i Shkencave” dhe titullin Profesor. Prof. Edmond Panariti ka kryer Studime të thelluara pasuniversitare gjatë viteve 1989 – 1992, pranë Shkollës Politeknike Federale (ETH) dhe Universitetit të Zyrihut në Zvicër. Në vitet 1995 – 2000, është fitues i dy bursave Fulbright për kërkim shkencor dhe ligjërimit në Universitetet e Kentakit dhe të Misisipit në SHBA. Në vitet 1994 – 1998 dhe 2004, kryen studime të thelluara pasuniversitare në Universitetin Veterinar të Hanoverit në Gjermani. Z. Edmond Panariti ka një karrierë të gjatë profesionale në Institutin e Kërkimeve dhe Fakultetin e Mjekësisë Veterinare. Edmond Panariti ka shërbyer si drejtues projekti në Organizatën Botërore të Shëndetësisë dhe aktualisht është Profesor titullar në Universitetin e Mjekësisë në Tiranë.

Z. Panariti, është anëtar i Kryesisë së Lëvizjes Socialiste për Integrim që prej vitit 2004. Ai ka mbajtur funksionet e Kryetarit të Komitetit Drejtues Kombëtar dhe të Sekretarit për Bujqësinë dhe Mjedisin. Në vitin 2011, Prof. Panariti zgjidhet anëtar i Këshillit Bashkiak të Tiranës dhe më pas emërohet Zëvendëskryetar i Bashkisë së Tiranës. Në vitin 2012, emërohet Ministër i Jashtëm i Shqipërisë dhe njëkohësisht mbajti edhe postin e Presidentit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.

NË 24 MARS 2015 , SENATI AKADEMIK I UNIVERSITÄ DEGLI STUDI DI PERUGIA I AKORDOI TITULLIN “HONORIS CAUSA” NË FUSHËN E MJEKSISË VETERINARE.

Prof. Edmond Panariti flet rrjedhshëm gjuhët angleze, gjermane, frënge dhe italiane.

### Gjokë Jaku Zv/Ministër

Ka lindur në Lezhë 24.09.1964 është i martuar me Znj. Marie Jaku dhe ka tre fëmijë, Evarist, Fjona dhe Mario.

Ka mbarua studimet e larta në vitet 1983-1987 ne Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, Dega Filozofi dhe Universitetin Luigj Gurakuqi, Shkodër , Dega Juridike, Viti 2004-2008. Në vitin 2011 është titulluar Avokat.

Është zgjedhur kryetar I Komunës Zejmen Lezhë në zgjedhjet e para lokale, 1992 si kandidat I pavarur deri në 1996.

1997-2000 ka punuar si Sekretar I Përgjithshëm dhe Prefekt I Prefekturës Shkodër

Nga viti 2000-2007 Kryetar I Bashkisë Lezhë, si përfaqësues I subjektit politik PS.

2009-2011 Deputet në Kuvendin E shqipërisë, si përfaqësues I PS

2014-2015 Ka punuar si Kordinator I Reformës Administrative Territoriale, për Qarkun Lezhë I kontraktuar nga UNDP.

Nga muaji Maj 2015 në funksionin e Zv/Ministrit të Bujqësisë.

### Sekretar i Përgjithshëm

Z. Vojo Bregu ka lindur në qytetin e Vlorës , më 26 prill të vitit 1975. Ai është i martuar dhe ka dy fëmijë, një djalë dhe një vajzë.

Në vitet 1993-1997 ka kryer studimet e larta në Universitetin e Tiranës, ku është diplomuar në Fakultetin e Shkencave Sociale, me titullin Punonjes Social dhe në vitet 1997-2003 ka kryer studimet e larta në Universitetin e Tiranës, ku është diplomuar në Fakultetin Juridik, me titullin Jurist.

#### **Kualifikimet**

Z. Bregu në Mars të vitit 2008 është licensuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë për ushtrimin e profesionit të Avokatit.

Në tetor të vitit 2005 ka ndjekur kursin "Mbi Falsifikimin e Euros" në Austri si Përfaqësues i Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

Në shkurt-mars të vitit 2002 ka ndjekur kursin "Intelligence Management", për nivelet drejtuese pranë Shërbimit Informativ Gjerman BND.

Në nëntor të vitit 2001 ka ndjekur kursin "Lufta kundër Terrorizmit Ekstrem" pranë Shërbimit Informativ Egjiptian.

#### **Ekspierenca pune**

Z. Vojo Bregu ka një CV të gjerë përsa i përket ekspierencave të tij në punë.

Në shtator 1997 – dhjetor 1999 ka punuar si specialist tek Shërbimi Kombëtar i Punësimit në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.

Në gusht 1999 – shkurt 2002 ka qenë asistent i përgjegjës të zyrës pranë Drejtorisë së Logjistikës në UNOPS-United Nations Office for Project Services, si dhe asistent logjistike dhe përkthyes për OSBE-Misioni i Kosovës.

Në dhjetor 2000 – prill 2001 ka qenë Inspektor i Marrëdhënieve me Publikun dhe i Problemeve Juridike të Kabinetit të Drejtorit pranë Shërbimit Informativ Kombëtar.

Nga muaji prill i vitit 2001 deri në mars të vitit 2003 ka mbajtur postin e Drejtorit të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë pranë Shërbimit Informativ Kombëtar.

Në janar 2003 deri në shtator të vitit 2008, z. Bregu ka ushtruar detyrën si Oficer i Policisë Gjyqësore në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë tek Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm.

Në vitet 2008-2013 ai ka ushtruar profesionin e Avokatit.

Aktualisht z. Vojo Bregu ushtron detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

#### **Gjuhët e huaja**

Z. Bregu zotëron shumë mirë gjuhën italiane, frënge dhe atë angleze.

#### **Këshilltar**

Zj. Brisilda Sotira Pullumbi . është këshilltare e Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave z. Edmond Panariti që prej 15 Tetorit 2013. Ka lindur në Tiranë, është e martuar me Z. Agron Pullumbi me të cilin ka një vajzë, Lorena Pullumbi Ka perfunduar studimet universitare në Universitetin Bujqësor të Tiranës në Fakultetin e Mjeksisë Veterinare. Mban titullin Master në Shëndet Publik, dhënë nga Fakulteti i Mjeksisë. Specializime në fushën e teknologjisë së informacionit, pranë Universitetit ORACLE ne Romë, Itali. Në fushën e shërbimit veterinar ka përvojën e 20 viteve duke punuar ne Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë. Znj Pullumbi ka treguar angazhim të fortë në zgjerimin dhe thellimin me ekspertizën e saj në fushat e politikës bujqësore me një bashkëpunim të suksesshëm dhe të gjatë me donatorët kryesorë në Shqipëri . Ajo ka marrë pjesë në zbatimin e

projekteve të rëndësishme strategjike në nivel kombëtar dhe rajonal , duke ndihmuar për të krijuar lidhje të forta midis ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë . Ka përvojë pune në projektet e BE të programeve PHARE, CARDS, IPA. Ndër arritjet e tjera , zonja Pullumbi ka qenë aktor i rëndësishëm në projektimin, vendosjen dhe menaxhimin e Sistemit shqiptar për Regjistrimin dhe Identifikimin e kafshëve , i pari i këtij lloji , realizuar në vend . Ka njohuri të shëndosha në drejtim të zhvillimeve të politikave bujqësore përmes procesit të tranzicionit në Shqipëri . Ka kontribuar në sferën akademike me artikuj shkencore që ndihmojnë të kuptuarit e sfidave të sektorit bujqësor në Shqipëri. Është fituese e dy bursave nga qeveria Hollandeze, në Wageningen University & Research Center, në vitin 2009 dhe 2012. Flet gjuhët Angleze dhe Italiane.

### **Këshilltar**

Z.Shaban Sulce është këshilltar I marrëdhëniet me publikun I Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave. Ka lindur në Çorovodë, më 10/09/1983.

Shaban Sulçe ka përfunduar studimet për gazetari në vitin 2006 në Fakultetin e Filologjisë, në Universitetin e Tiranës. Aktualisht është duke zhvilluar studimet master, dega Marketing, Universiteti European I Tiranës.

Sulçe ka një karrierë mbi 10 vjeçare në fushën e gazetarisë. Ai ka punuar fillimisht në mediat sportive si Telesport dhe Panorama Sport, për të punuar më pas si gazetar politike në gazetat Panorama, Albania dhe si kryeredaktor I Gazetës Integrimi. Shaban Sulce ka punuar për gati dy vjet si Drejtor I Kujdesit Social në Bashkinë e Tiranës dhe vjen në këtë detyrë pas eksperiencës 7 mujore si konsulent I marrëdhënieve me publikun I Projektit LAMP të Bankës Botërore në bashkëpunim me Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Shaban Sulçe është njohës dhe përdorues i mirë i gjuhëve angleze dhe italiane.